

Ministri i Jashtëm i Turqisë, Mevlüt Çavu?o?lu, kritikoi presidentin e Parlamentit Evropian, David Sassoli, për pretendimin e tij në lidhje me përmbajtjen e takimit të tyre, transmeton Anadolu Agency (AA).

Çavu?o?lu dhe Sassoli u takuan në Bruksel, ku sot u mbajt Takimi i Ministrave të Jashtëm të NATO-s.

Pas takimit, Sassoli postoi në Twitter se ka shprehur shqetësime për operacionin ushtarak turk në veri të Sirisë.

Çavu?o?lu iu përgjigj postimit duke thënë se kjo çështje nuk është diskutuar në takim.

"Ky është një shembull tjetër i joshinjeritetit dhe hipokrizisë së BE-së. Presidenti i Parlamentit Evropian ndau tema që nuk m'u thanë në fytyrë. I tronditur që personi që përfaqëson popujt evropianë shtrembëron përmbajtjen e takimit", tha kryediplomati turk./AA/